

Z. Artur Lazebeu

Mban pozicionin e Drejtorit të Shërbimeve të Mirëmbajtjes pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Është diplomuar me titullin “Jurist” në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 2004. Në vitin 1999-2000 ka kryer studime politike pasuniversitare pranë Universitetit Westminster, Londër. Në vitin 1986 ka përfunduar studimet në Fakultetin Filologjik, Tiranë, për Gjuhë dhe Letërsi Ruse si dhe kursin dyvjeçar për gjuhë Serbo-Kroate dhe Histori-Gjeografi të Ballkanit.

Nga 1986 – 1992 ka punuar gazetar-përkthyes pranë ATSH-së dhe pedagog i jashtëm pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Nga 1992 – 2000, angazhuar në sektorin privat dhe në kuadër të shoqërisë civile. Nga 2000 – 2012 ka punuar në institucionin e Avokatit të Popullit, si Këshilltar dhe Drejtor Kabineti. Në vijim, pedagog i jashtëm pranë Kolegjit Universitar “Akademia Profesionale e Biznesit”, Fakulteti Juridik, Tiranë. Në 2017 – 2018, Këshilltar pranë Kabinetit të Ministrisë të Mbrojtjes.

Ka veprimtari në fushën e publicistikës dhe është autor/bashkë-autor i disa botimeve. Ka marrë pjesë në trajnime tematike dhe ka referuar në konferenca brenda dhe jashtë vendit, mbi mirëqeverisjen, të drejtat e njeriut, antikorrupsionin, rritjen e besimit tek institucionet publike etj.